

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË ORGANIZIMIT DHE
FUNKSIONIMIT TË INSPEKTORATIT TË PËRGJITHSHËM

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektakti është të garantojë organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm si një strukturë e re institucionale, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të krijojë bazat administrative dhe funksionale për ushtrimin e kompetencave të tij si autoritet koordinues, mbikëqyrës dhe zhvillues në sistemin e inspektimeve në nivel qendror dhe vendor.

Projektakti synon të:

- Përcaktojë rregullat për funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm si institucion publik, qendror, në varësi të Kryeministrit;
- Përshkruajë detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të Inspektoratit të Përgjithshëm ndaj inspektorateve qendrore dhe vendore;
- Formalizojë rolin e Inspektoratit të Përgjithshëm si një njësi mbikëqyrëse për zbatimin e politikave të inspektimit, programimin dhe standardizimin e procedurave;
- Përcaktojë mënyrën e organizimit të brendshëm dhe funksionimit administrativ të institucionit;
- Sigurojë një proces të qartë për bashkëveprimin institucional, përfshirë përdorimin dhe administrimin e sistemit elektronik të inspektimeve “e-Inspektimi”;
- Mbështesë transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin në veprimtaritë inspektuese në të gjitha nivelet e administratës publike;

- Regjistrojë riorganizimin ligjor të Inspektoratit Qendror në Inspektoratin e Përgjithshëm dhe trajtimin e marrëdhënieve të punës për punonjësit ekzistues.

Ky projektakt përbën një ndër hapat kyç për zbatimin e reformës në sistemin e inspektimeve, duke forcuar rolin qendror të Inspektoratit të Përgjithshëm si garant i standardeve dhe i koordinimit institucional në këtë fushë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave për reformën e inspektimeve, rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në administratën publike. Gjithashtu, ky projektakt është në përputhje edhe me Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2025.

Ai kontribuon në ndërtimin e një sistemi të integruar inspektimi dhe përmbush kërkesat e ligjit nr. 99/2024, për ngritjen dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm. Ky projektakt, gjithashtu, mbështet synimet e dokumenteve strategjike për integrimin evropian dhe qeverisjen e mirë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm paraqet një zhvillim të domosdoshëm për zbatimin praktik të reformës së inspektimeve, në vijim të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Ky akt nënligjor shërben si bazë organizative dhe procedurale për operimin efektiv të institucionit të ri, i cili zëvendëson Inspektoratin Qendror dhe merr funksione të zgjeruara në nivel kombëtar.

Problematikat ekzistuese që adreson projektakti:

- Mungesa e një kuadri të detajuar ligjor për organizimin e Inspektoratit të Përgjithshëm, si institucion i ri, me funksione horizontale dhe koordinuese mbi të gjitha inspektoratet qendrore dhe vendore;

- Mos përcaktimi i qartë i roleve dhe marrëdhënieve ndër-institucionale në funksion të kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarive inspektuese;
- Nevoja për standardizimin e procedurave të punës së brendshme dhe të ndërtimit të strukturës organizative sipas objektivave të reformës;
- Pasiguri në administrimin e sistemit elektronik unik të inspektimeve “e-Inspektimi” dhe mungesa e një autoriteti qendror përgjegjës për menaxhimin e tij.

Përparësitë kryesore të projektaktit:

- Krijimi i një institucioni funksional të pavarur nga strukturat sektoriale, me rol qendror në mbikëqyrjen, koordinimin dhe harmonizimin e praktikave inspektuese;
- Garantimi i një procesi të unifikuar të monitorimit të performancës së inspektorateve dhe inspektorëve përmes treguesve standard të vlerësimit dhe raportimit periodik;
- Konsolidimi i sistemit “e-Inspektimi” i detyrueshëm për të gjitha procedurat inspektuese;
- Mbështetja institucionale për realizimin e programeve të trajnimit, vlerësimit dhe zhvillimit të karrierës së inspektorëve;
- Përcaktimi i rregullave për menaxhimin e bazës së të dhënave të inspektimit dhe raportimit për politikën publike në këtë fushë.

Efektet e pritshme nga miratimi i projektaktit:

- Funkcionalizimi i Inspektoratit të Përgjithshëm si strukturë shtetërore me kapacitet të plotë ligjor dhe administrativ;
- Rritja e efikasitetit dhe besueshmërisë së sistemit inspektues në Shqipëri përmes qartësimit të kompetencave dhe forcimit të kontrollit të brendshëm;
- Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë në veprimtarinë inspektuese përmes standardeve të përbashkëta për raportim dhe veprim institucional;
- Lehtësimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe përdorimi më efektiv i të dhënave elektronike në funksion të monitorimit dhe vendimmarrjes publike;

- Konsolidimi i procesit të ristrukturimit të Inspektoratit Qendror në përputhje me afatet dhe parashikimet ligjore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është hartuar në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës, ligjin nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe legjislacionin përkatës në fuqi që rregullon organizimin e administratës shtetërore.

Ai nuk bie ndesh me asnjë akt tjetër në fuqi dhe plotëson kuadrin nënligjor për funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm si organ i administratës qendrore.

Gjithashtu, ky projektakt nuk përbën një akt nënligjor që sjell përfitime shtesë për subjektet e përfshira dhe, për pasojë, nuk bie ndesh me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimin përkatës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky vlerësim mbështetet në sqarimet e dhëna në shkresën zyrtare të KQZ-së, nr. prot. 1546, datë 03.03.2025, mbi interpretimin dhe zbatimin e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, si dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektvendimi nuk synon përafrimin e drejtpërdrejtë me *Acquis Communautaire*, por ndihmon në përmbushjen e objektivave të përafrimit të administratës publike shqiptare me standardet e Bashkimit Evropian, nëpërmjet ngritjes së mekanizmave të kontrollit dhe transparencës.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJESSË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit të Përgjithshëm” është hartuar në zbatim të nenit 12, pika 3, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e organizimit institucional, funksionimit administrativ dhe ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit të Përgjithshëm si strukturë qendrore publike në varësi të Kryeministrit.

Projektvendimi përmban 5 krerë, të strukturuar në pika, si më poshtë:

- Kreu I – Dispozitat e përgjithshme për statusin, varësinë dhe qëllimin e Inspektoratit të Përgjithshëm;
- Kreu II – Përgjegjësitë funksionale të institucionit në raport me inspektoratet qendrore dhe vendore, përfshirë monitorimin, raportimin dhe administrimin e sistemit të inspektimeve;
- Kreu III – Organizimi dhe drejtimi i brendshëm i institucionit, përfshirë strukturën, marrëdhëniet e punës dhe kompetencat e Inspektorit të Përgjithshëm;
- Kreu IV – Rregullat për stemën, vulën dhe logon zyrtare si mjete identifikuese institucionale;
- Kreu V – Dispozitat kalimtare dhe të fundit që rregullojnë ristrukturimin nga Inspektorati Qendror në Inspektoratin e Përgjithshëm dhe transferimin e personelit ekzistues.

Projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit të Përgjithshëm” është hartuar në zbatim të nenit 12, pika 3, të ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e organizimit institucional, funksionimit administrativ dhe ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit të Përgjithshëm si strukturë qendrore publike në varësi të Kryeministrit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Inspektorati i Përgjithshëm, si institucioni përgjegjës për organizimin, drejtimin dhe funksionimin e strukturës së re, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Gjithashtu, për zbatimin e dispozitave kalimtare dhe transferimin e strukturës dhe punonjësve nga Inspektorati Qendror në Inspektoratin e Përgjithshëm, ngarkohen:

- Kryeministria, për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Përgjithshëm;
- Departamenti i Administratës Publike, për mbështetjen në procesin e trajtimit të nëpunësve civilë dhe punonjësve administrativë, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi;
- Ministria e Financave, për mbështetjen buxhetore dhe financimin e institucionit, në përputhje me kërkesat dhe planifikimet buxhetore të miratuara.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga Inspektorati Qendror (në proces ristrukturimi si Inspektorati i Përgjithshëm), në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. Gjatë procesit të përgatitjes, projektakti është konsultuar paraprakisht me Ministrinë e Drejtësisë.

Ky bashkëpunim është zhvilluar në zbatim të Urdhrit nr. 49, datë 26.03.2025, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit drejtues ndërinstitucional të punës dhe grupeve teknike ndërinstitucionale për riorganizimin dhe ristrukturimin e inspektorateve në Republikën e Shqipërisë, për hartimin e projektakteve nënligjore në funksion të zbatimit të ligjit për inspektimin, si dhe për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit elektronik të inspektimeve ‘e-Inspektimi’”.

Projektakti do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, Departamentin e Administratës Publike, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si dhe Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, në përputhje me kërkesat për konsultim ndërinstitucional dhe koordinimin e reformës në sistemin e inspektimeve.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti nuk shoqërohet me kosto financiare për buxhetin.

PROPOZUESI

**MINISTRI I SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E
BIZNESIT**

Delina IBRAHIMAJ

